

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rrjeti i Agasit/ Mes tenderëve të AKSHI-t, pengmarrjes së Meçes dhe sekreteve të SHISH
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/rrjeti-i-agasit-mes-tenderëve-te-akshi-t-pengmarrjes-se-meces-dhe-sek-i106124
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 20:31:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 20:16:12 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c8569d93a4a8a6226b03073470be52d9e62dfd3403b300f0670e6028078e8682
TEKSTI	3e811e168fa2da8acb1d75517cf70c76195f336901d24b8629e8f57707399607
PAMJA	b450c05d4a2dae527a28b95ac144792ffb69ec63247250d3cf67722423dec226

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3f6f2c807e605cc969cff0b4ee696ef415865a8edce99fee9c76b47107a7efd8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6df622084e2aa16fa426f4c8614ee06bfd4531cb8fc83f4931cef87e966f1ea1
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3f6f2c807e605cc969cff0b4ee696ef415865a8edce99fee9c76b47107a7efd8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: [Limaj rikthehet në](#) [Vjeçare, nënë e dy fëmijëve](#) ■ [ne Shqipëri për](#) [Iku 3 herë nga Shqipëria. Herën e](#) ■ [Shkujt rregulloreje/ Kush është](#) [në Marqinet të qytetit të Vlorës](#) ■ [Pse nesht kryeministri nër](#) [me të rëndësishme të sigurisë](#) ■ [ndodh me policin Altin](#) [historinë e përplasjeve të tij me](#) ■ [vazhi Cili ë](#)

[AKTUALITET](#)

Rrjeti i Agasit/ Mes tenderëve të AKSHI-t, pengmarrjes së Meçes dhe sekreteve të SHISH

Piranjat Përditësimi i fundit 25 Shtator 2026, 22:16



Ai që nisi si një hetim mbi mënyrën e dhënies së tenderëve të AKSHI-t, tashmë është kthyer në një skemë shumë më të gjerë, ku në fokus nuk janë më vetëm kompanitë private, administrata, grupet e strukturuar kriminale, por edhe mënyra se si këto hallka dysohet se janë lidhur me policinë dhe SHISH-in.

Zhvillimet e fundit të SPAK, 22 shtator 2026, e kanë zgjeruar këtë hartë deri te strukturat e sigurisë, duke e çuar çështjen në një tjetër nivel me përfshirjen e emrit të ish-drejtores së SHISH, Vlorë Hyseni.

Përfshirja e saj, ka zbuluar lidhjet me eksponentët të krimit të organizuar, duke shkaktuar një tronditje të vërtetë në themelet e sigurisë kombëtare.

Në qendër të hetimit qëndrojnë Ergys Agasi dhe Ermal Beqiraj, ndërsa në dosje shfaqen emrat e ish-drejtores së AKSHI-t, Mirlinda Karçanaj dhe ish-zyrtarit të policisë, Erjon Ismaili.

Është pikërisht zhvillimi i fundit ai që e ndryshon përmasën e dosjes: më 24 shtator 2026, GJKKO caktoi ndaj Hysenit masën "arrest në shtëpi" dhe pezullimin nga detyra.

Sipas SPAK ajo hetohet për përkrahje të autorit të krimit dhe zbulim të të dhënave sekrete.

Nga materialet e publikuara në media së fundmi, të cilat i referohen dosjes së SPAK, pika më e fortë nuk është thjesht pretendimi për një marrëdhënie personale, por intensiteti i komunikimit, natyra e mesazheve dhe fakti që komunikimi ka vijuar ndërsa Agasi ishte në kërkim.

Në dhjetor 2025, SPAK vendosi masa sigurie ndaj disa personave, ndërsa Agasi dhe Beqiraj u shpallën në kërkim.

Më pas, Agasi u arrestua në Shqipëri më 26 gusht, ndërsa Beqiraj u arrestua në Francë në 28 korrik 2026.

Në këtë fazë të hetimit, emri i Mirlinda Karçanajt, ish-drejtoreshë e AKSHI-t, del si një prej zyrtareve që janë në hetim. Ndaj saj u caktua masë sigurie "arrest në shtëpi" në 16 dhjetor 2025, por pas disa javësh masa u ndryshuar në "detyrim paraqitje".

Si fraksion i dosjes "AKSHI", prokurorët e SPAK, Altin Dumani dhe Bledar Maksuti, urdhëruan edhe ekzekutimin e dy masave të tjera sigurie, arrestimin e Fatjon Kalluçit, Shefi sektori në Policinë shqendore dhe Embro Sulejmanit, punonjës në shoqërinë "Agroturizëm Kodra e Kuajve" në Durrës.

Kalluçi akuzohet për veprën penale të zbulimit të akteve ose të të dhënave sekrete, ndërsa Sulejmani akuzohet për përkrahje të autorit të krimit.

Por hetimi do të merrte një kthesë shumë më të fortë kur në dosje u fut historia e biznesmenit Gerond Meçe.

Më 12 gusht 2025, Gerond Meçe doli nga banesa e tij në Tiranë. Sipas dëshmisë së tij në SPAK, referuar edhe dosjes hetimore, pranë tij u afërua një automjet "Land Rover Defender" me fenelina policie.

Persona të veshur me elementë të ngjashëm me uniformat e policisë dhe BKH-së iu prezantuan si punonjës të drejtësisë dhe i kërkuan të hipte në automjet.

"Jemi SPAK-u, duhet të vish me ne, hyr në makinë", – i është drejtuar një prej tyre Meçes.

Pak minuta më pas, sipas dëshmisë, ai kuptoi se nuk ishte arrestuar nga autoritetet.

I vendosën një kapuç në kokë dhe automjeti mori drejtimin drejt Kërrabës dhe Elbasanit.

Në zonën e Gracenit, sipas Meçes, situata u kthye në një kërcënim të hapur. Atij iu kërkua kodi i telefonit dhe më pas iu treguan dokumente që lidhnin drejtpërdrejt pengmarrjen me aktivitetin e tij në tenderët e AKSHI-t.

Bëhej fjalë për procedura për të cilat kompania e tij kishte bërë ankime në Komisionin e Prokurimit Publik.

Kërkesa, sipas dëshmisë, ishte e drejtpërdrejtë: të tërhiqte ankimet dhe të qëndronte jashtë garës.

megjunate, meqe tnote se e kisnte kuptuar qe isnte marre peng, pasi personat ne makine qe isnin prezantuar si punonjes te BKH-se, nuk dinin t i vendosnin prangat ne quar.

Vetëm pasi biznesmeni pranoi të heqë dorë nga këto ankime, rëmbyesit e lanë të lirë, duke e braktisur në një zonë rurale të qarkut të Elbasanit.

Pas 6 orësh pengmarrje, e zbrisin te rrethrotullimi që të çon direkt për në autostradën Tiranë-Elbasan, në afërsi të Bradasheshit dhe njëri prej tyre i thotë: “Nuk dua probleme nga ty, nuk dua denoncime nga ty, në të kundërt do të vrasim ty, grua, motër, nënë. Se baba ti nuk ke”.

SPAK dyshon se pengmarrja ishte pjesë e mekanizmit për eliminimin e një rivali në procedurat e prokurimit.

Në këtë linjë hetimi janë përmendur Agasi dhe Beqiaj, ndërsa hetuesit kanë kërkuar të përcaktojnë edhe rolin e personave të tjerë.

“Në momentin që ankimet e shtetasit Gerond Meçe, në cilësinë e ortakut të shoqërisë ‘Advanced Business Solutions-ABS’, krijuan një mekanizëm bllokues për përfundimin e procedurave të prokurimit pranë AKSHI-t, ai u mor peng forcërisht, duke e detyruar të heqë dorë nga të gjitha procedurat e ankimuar”, – shpjegon SPAK në dosje.

SPAK sqaron se heqja dorë e Meçes nga ankimet, pranë KPP-së, do t’i krijonte lehtësira të konsiderueshme Agasit dhe Beqirajt me qëllim vijimin e aktivitetit kriminal në fushën e prokurimeve publike, i cili ishte pezulluar në disa raste për shkak të ankimeve të bëra në KPP nga shoqëria “Advanced Business Solutions-ABS”.

“Nga këqyrja e pamjeve filmike, arsyeshëm, krijohet bindja, mbi lidhjet me interes që kanë këta shtetas me njëri-tjetrin, të cilat, nga analizimi i përmbajtjes së bisedave të transkriptuara, krijon dyshimin e arsyeshëm mbi realizimin e një skeme kriminale në funksion të paracaktimit të procedurave të prokurimit, krijimin të avantazheve dhe përfitimit të paligjshëm prej tyre. Kjo vihet re në disa nga bisedat e kryera, ku diskutohen çështje si “projekti bën 2 milionë, ne do ta bëjmë 4”, ose “Nuk futet as në eksperiencë”, të cilat kanë të bëjnë me përcaktimin e kriterëve të procedurave të prokurimit, vlerave të kontratave që do të publikohen etj”, – thekson SPAK.

Pse del në dosje Erjon Ismaili?

Një tjetër hallkë është ajo e policisë. Gerond Meçe ka deklaruar se, përpara pengmarrjes, zv/drejtori i Policisë së Tiranës, Erjon Ismaili, i pezulluar nga detyra, i kishte përcjellë një paralajmërim që të qëndronte larg tenderëve të AKSHI-t.

Pikërisht kjo dëshmi është përdorur për të hetuar lidhjet e Ismailit me grupin e dyshuar. Në dhjetor 2025 ndaj tij u raportua masë pezullimi nga detyra.

Kështu, sipas akuzave, skema nuk kufizohej vetëm te kompanitë që konkurronin për kontratat publike. Në dosje shfaqet një trekëndësh: biznes – administratë – polici.

Në dosjen e SPAK, thuhet se në faqen numër 31 të materialit, konstatohet biseda mes shtetasve Ergys Agasi dhe Ermal Beqiraj, ku diskutohet për dy tenderë për procedurë, si dhe përmendet kompania “ABS” e Meçes.

Nga kjo bisedë, rezulton se personat nën hetim, janë të shqetësuar për praninë e kompanisë “ABS” me ortak Gerond Meçen.

Pikërisht këtu nis kapitulli i ri i dosjes. Materialet e sekuestruara nga hetuesit gjatë hetimit ndaj Agasit, ku një rol kyç ka pasur zbërthimi i telefonit pas arrestimit të tij në Durrës, kanë çuar në komunikime të shumta me drejtuesin e SHISH, Vlorë Hyseni.

Sipas materialeve të publikuara nga media që u referohen dokumenteve të SPAK/GJKKO, bëhet fjalë për qindra komunikime telefonike, mesazhe dhe videocall-e mes tyre gjatë periudhës kur Agasi ishte në kërkim.

Një pjesë e komunikimeve datojnë nga fundi i qershorit deri në ditët para arrestimit të tij më 26 gusht 2026.

Në këto komunikime shfaqen edhe shprehje personale si “zemër” dhe “shpirt”, ndërsa në disa raste Hyseni i përcjell Agasit informacion mbi takime dhe lëvizje të saj zyrtare.

Një prej mesazheve të publikuara në media është ai ku Hyseni i shkruan se duhet të takohet me “KM”-në, ndërsa në një tjetër përmend takimin me drejtuesin e Policisë së Shtetit dhe shpresën se ai kishte marrë porosi nga kryeministri.

Këto komunikime janë bërë tashmë pjesë e linjës së re të hetimit.

I njëjti emër, dy dosje që tashmë takohen

Këtu dosja e “AKSHI”-t dhe dosja “Hyseni–Agasi” shkojnë zinxhër.

Në njërën anë është një skemë e dyshuar për tenderët publikë, ku konkurrenca mes kompanive pretendohet se është manipuluar dhe ku një biznesmen, sipas dëshmisë së tij, është marrë peng për t’u tërhequr nga ankimet.

Në anën tjetër është një biznesmen tjetër – Agasi – i cili, ndërsa ishte në kërkim, vijonte të komunikonte me drejtuesin e SHISH-it dhe, sipas materialeve të bëra publike, merrte prej saj informacione mbi aktivitetin e saj zyrtar.

Mes këtyre dy kapitujve shfaqen emrat e Ermal Beqirajt, Mirlinda Karçanajt dhe Erjon Ismailit, ndërsa në qendër qëndron Ergys Agasi.

Nëse në dhjetor 2025 çështja e AKSHI-t dukej si një hetim mbi manipulimin e prokurimeve publike, zhvillimet e shtatorit 2026 e kanë zgjeruar ndjeshëm hartën e saj.

Agasi është nyja që i lidh disa prej episodeve.

Beqiraj është emri tjetër kryesor i biznesit në skemën e hetuar.

Karçanaj përfaqëson hallkën institucionale brenda AKSHI-t.

Ismaili shfaqet në linjën e hetimit që prek Policinë.

Meçe është biznesmeni që, sipas dosjes, u përdor si objekt presioni për të dalë nga gara dhe për të tërhequr ankimet.

Dhe tani **Vlorë Hyseni**, ish-drejtuese e SHISH-it, është bërë pjesë e hetimeve, për shkak të komunikimeve me Agasin dhe dyshimeve që lidhen me informacionin e klasifikuar.

Tenderë fiktiv me Karçanajn dhe Beqirajn

Prokuroria e Posaçme, duke zbardhur skemën e dyshuar të korrupsionit dhe pastrimit të parave në tenderët e AKSHI-t, përmend emrat e Ergys Agasit, Mirlinda Karçanajt, Ermal Beqirajt dhe një rrjet kompanish të lidhura mes tyre.

Sipas dosjes hetimore, skema dyshohet se është ndërtuar mbi tenderë të paracaktuar, fatura fiktive dhe transferim fondesh publike drejt shoqërive të kontrolluara nga të hetuarit.

Sipas hetimit dhe vendimit të sekuestrimit nga GJKKO, mes viteve 2023 dhe 2025, Agasi dyshohet se ka përfituar mbi 9 milionë euro në formë rryshfeti për ndikimin e tij në paracaktimin e tenderëve të AKSHI-t.

Prokurorët, krijojnë dyshimin e arsyeshëm, se personat në hetim, Ergys Agasi, Ermal Beqiraj dhe persona të tjera të paidentifikuar, kanë kryer veprat penale të “Heqjes së paligjshme të lirisë”, “Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës”, në kuadër të një formacioni të posaçëm “Grup i strukturuar kriminal” dhe kryerja e vepraave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal.

Ndërsa për Karçanajn, Prokuroria e Posaçme vëren se ish-drejtoresha e AKSHI-t, është e dyshuar për veprat penale “Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tenderë apo ankande publike”, e kryer në formën e veçantë të grupit të strukturuar kriminal dhe “Grupi i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grup i strukturuar kriminal”.

Presioni nuk i shpëtoi as Damian Gjikhuri!

Sipas dokumenteve hetimore, Ergys Agasi, në komunikime më 06.03.2019 me ish-deputetin Alqi Bllako, flet për një “situatë”, ku ish-ministri Damian Gjikhuri dyshohet se kishte krijuar “pengesa” për realizimin e përfitimeve të paligjshme të këtij grupi.

Nga përmbajtja e bisedave të sekuestruara, SPAK identifikon se personi i quajtur “Labi” është Elgerti Bixha.

Sipas dosjes, Agasi synonte ta emëronte Bixhën administrator në një shoqëri private, e cila kishte fituar një koncesion me ministrinë e drejtuar në atë kohë nga Gjikhuri.

Hetimi thekson se Gjikhuri konsiderohej si “pengesë” për realizimin e këtyre përfitimeve, çka çon në diskutime për mënyra të tjera presioni për ta “hequr” këtë pengesë.

Në një mesazh të datës 06.03.2019, ora 21:54:43, Ergys Agasi shprehet tekstualisht: “Do ja *i robt, do fusim çunat pastaj”.

Sipas SPAK-ut, kjo frazë interpretohet si përdorim i lidhjeve me persona me trezikhmëri të lartë shoqërore, për të ushtruar presion dhe për të eliminuar pengesat ndaj interesave të grupit.

Dosja lidh këtë rrethanë edhe me pengmarrjen e shtetasit Gerond Meçe, duke theksuar se i njëjti “modus operandi” ishte përdorur më herët edhe ndaj ish-ministrit Gjikhuri, përmes ankesave të shumta pranë KPP-së me qëllim bllokimin e procedurave të prokurimit pranë Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 25 Shtator21:21

[Sherr masiv në Korçë, shoqërohen në polici tre persona](#)

Në Korçë në mbrëmjen e sotme janë shoqëruar në komisariat tre persona, pasi janë konfliktuar me njëri-tjetri...

AKTUALITET 25 Shtator20:27

[Plotësohen vakancat, zgjidhet dhe anëtarja e tretë e KLGJ-së](#)

Janë plotësuar të gjitha vakancat në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Përfaqësuese nga Gjykatat e Shkallës së...

AKTUALITET 25 Shtator19:33

[“Marrim 250 mijë pension me bashkëshorten! Me se do jetojmë?”/ I moshuari thirrje rinisë: Për 3 ditë e rrëzoni qeverinë](#)

Një i moshuar ka rrëfyer vështirësitë që, sipas tij, ka hasur në sistemin shëndetësor shqiptar dhe situatën e ...

AKTUALITET 25 Shtator19:19

[Në vështirësi financiare, 40-vjeçari shqiptar kryen grabitjen dhe arratiset! Rugës kupton gabimin me celularin, por ishte tepër vonë](#)

Sapo i kishte shkëputur një varëse nga qafa e një gruaje dhe ishte larguar me një SUV me ngjyrë të errët, por, në n...

AKTUALITET 25 Shtator19:16

[Protesta kundër qeverisë/ Nis marshimi drejt Kryeministrisë: Shitet qeveria, jo Shqipëria](#)

Qytetarët kanë nisur marshimin drejt Kryeministrisë, ku dhe pritet që të zhvillojnë fjalimet e tyre. Pjesëmarrja e tyre ë...

AKTUALITET 25 Shtator19:11

[Priti 41 kg drogë nga Kanadaja, 46-vjeçari shqiptar hesht në gjykatë](#)

46-vjeçari shqiptar, i mbrojtur nga avokati Gianluca Carlone, me banim në Chieti dhe i arrestuar në një hotel në Rimini, zgjodhi t&eu...

AKTUALITET 25 Shtator19:02

[Zgjidhet anëtar i tjetër i KLGJ-së nga radhët e Apelit](#)

Ka përfunduar votimi edhe për anëtarin tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Mësohet se anëtar i dyt&e...

AKTUALITET 25 Shtator18:13

[“Pse më sheh?”/ Reperi nga Tropoja goditi me thikë, babai i të plagosurit qëllloi me armë! Zbardhet plagosja e kosovarit tek “Zogu i Zi”](#)

Zbulohen detaje nga konflikti me armë zjarri që ndodhi mesditën e sotme në Tiranë, në zonën e “Zogut të Zi” ...

AKTUALITET 25 Shtator18:02

[Vota kokë më kokë! Zgjidhet me short anëtar i ri i KLGJ-së nga radhët e Gjykatës së Lartë](#)

Pas numërimit të votave të kandidatëve të Gjykatës së Lartë, për anëtar të Këshillit të Lart&eu...

AKTUALITET 25 Shtator17:52

[Pastroi miliona para në Shqipëri nga trafiku i drogës, gati ekstradimi i Eldi Dizdarit në Belgjikë](#)

Eldi Dizdari, sic njihet ndryshe Denis Matoshi, pjesë e rrjetit të trafikut të kokainës nga Amerika Latine, do të ekstradohet nga Emira...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 25 Shtator

[“Më quajti lopë kur isha shtatzënë”/ Pas videos...](#)

Një situatë e paprecedentë raportohet të ketë ndodhur një muaj më parë në qytetin e Durrësit, ku shefi i Kom...

SHOWBIZ 25 Shtator

["Fjeta milioner dhe u zgjova i rrënuar", Robert...](#)

Roberto Carlos ka rrëfyer një nga periudhat më të errëta të jetës së tij, duke zbuluar kalvarin me të cilin u pëeum...

AKTUALITET 25 Shtator

["Bleona është gjallë!"/ Gjyshi rrëfen misteri...](#)

Prej 16 vitesh, fati i Bleona Matës mbetet i pazbardhur. Vajza vetëm 6 vjeçe humbi gjurmët më 22 maj 2010 në Zapod të Kuk...

INVESTIGIME 25 Shtator22:29

[Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!](#)

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

video



Institucionet në shërbim të krimit: Pse hesht kryeministri për skandalet?



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.